



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



ZGJEDHJET E PARAKOHSHME PËR KUVENDIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

6 tetor 2019

VOTIMI PËRMES POSTËS

Periudha e aplikimit/regjistrimit 30 gusht - 10 shtator 2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i Republikës së Kosovës është duke bërë përgatitjet për organizimin e Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës **6 tetor 2019**.

Të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës që jetojnë jashtë vendit mund të aplikojnë për regjistrim për të votuar përmes postës.

Formularin për regjistrim për Votim Përmes Postës mund ta siguron nga:

- www.kqz-ks.org;
- Linja ndihmëse e Operacionit të votimit përmes postës
+ 383 038 213 100
+ 383 038 213 200; dhe
- Ambasadat dhe konsullatat e Republikës së Kosovës.

Për ta fituar të drejtën e votimit përmes postës, ju duhet që:

Të jeni nga mosha 18-vjeçare në ditën e votimit, më **6 tetor 2019**;

Të jeni shtetas i Republikës së Kosovës dhe të keni dokument të identifikimit të Republikës së Kosovës; dhe

Të dëshmoni se keni të drejtë për t'u regjistruar në Regjistrin Civil të Republikës së Kosovës.

Aplikacionet për votim përmes postës duhet të arrijnë në KQZ deri më **10 shtator 2019**.

Aplikacionin e plotësuar mund ta dërgoni:

- Përmes postës në adresë të KQZ-së, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Votimi Përmes Postës, K.P. 6, Kutia 351, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës;
- Përmes e-mailit zyrtar në njërin nga këta: ovpp@kqz-ks.org, vjk.2019@kqz-ks.org, zgjedhjet.2019@kqz-ks.org, dhe ogpp@kqz-ks.org; dhe
- Përmes faksit: + 383 038 213 200

Nëse ju aplikoni për t'u regjistruar përmes e-mailit, aplikacionin tuaj duhet ta dërgoni vetëm për vete përmes postës elektronike personale (e-mailit).

Ju njoftojmë se aplikacionet mund t'i dërgoni për rrethin e ngushtë familjar që përmban të njëjtin mbiemër, e jo edhe për persona të tjerë. Nëse dërgoni aplikacione për personat jashtë rrethit të ngushtë familjar, aplikacionet për regjistrim do të refuzohen!